

KUJTESË

I/e nderuar koleg/e,

Bazuar në legjislacionin në fuqi, me qëllim ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik ju rikujtojmë se:

1. Drejtuesi teknik është përgjegjës për gjithë veprimtari të profesionale dhe teknike që zhvillohet në subjektin farmaceutik për të cilin është certifikuar
2. Drejtuesi teknik e ushtron profesionin me kohë të plotë vetëm në subjektin farmaceutik për të cilin është certifikuar.
3. Drejtuesi teknik duhet të jetë në dijeni me çdo levizje të stafit në subjektin farmaceutik për të cilin është certifikuar.
4. Drejtuesi teknik duhet të jetë rezident i përhershëm në njësinë administrative ku ushtron aktivitetin subjektin farmaceutik për të cilin është certifikuar.
5. Drejtuesi teknik duhet të jetë rezident i përhershëm në Republikën e Shqipërisë dhe nuk mund të qëndrojë më shumë se 4 javë kalendarike jashtë vendit
6. Drejtuesi teknik duhet të njoftojë menjëherë UFSH-në për çdo rast të ndryshimeve të mundshme, përfshirë edhe mbylljen e aktivitetit.
7. Drejtuesi teknik duhet të njoftojë UFSH-në për çdo rast evidentimi të një shkelje tërëndë të legjislacionit, statutit dhe kodit etikës deontologjik farmaceutik.
8. Subjektin farmaceutik ku drejtuesi teknik nuk është pronar, duhet që përveç drejtuesit teknik, të ketë të paktën edhe një farmacist të punësuar.

Në nenin 19 të Statutit të Urdhrit janë të parashikuara masat e

mëposhtme:

- a. Kur në subjektin farmaceutik gjendet duke shërbyer një person jo farmacist, drejtuesit teknik i hiqet ky funksion në mënyrë të menjëhershme për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
- b. Kur deklaratat e bëra tek formulari i ndryshimeve janë të rreme, drejtuesit teknik i hiqet ky funksion në mënyrë të menjëhershme për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
- c. Kur në subjektin farmaceutik gjendet, në mënyrë të përsëritur, duke shërbyer një farmacist pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve, drejtuesit teknik i hiqet ky funksion në mënyrë të menjëhershme për një periudhë 1 (një) vjeçare.

PËR ANËTARËT E RINJ

Bazuar në legjislacionin në fuqi, ju kujtojmë se:

1. Çdo anëtar, që pajiset me certifikatë të lejes së ushtrimit të profesionit nga Urdhri i Farmacistëve duhet të regjistrohen në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë tek ASCK (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor) nëpërmjet portalit e-Albania (Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë)
2. Çdo anëtar duhet të ndjekë Aktivitetet e Edukimit në Vazhdim për të plotësuar 15 kredite brenda një viti dhe 75 kredite deri në fund të ciklit 5 vjeçar (cikli nis nga data e anëtarësimit tek Urdhri i Farmacistëve). Cikli i edukimit në vazhdim është individual. Shembull : Në qoftë se një farmacist është anëtarësuar me datën 20.02.2026 duhet të plotësojë 75 kredite deri në datën 19.02.2031, të shpërndara si më poshtë;

20.02.2026 - 19.02.2027 15 kredite;
20.02.2027 - 19.02.2028 15 kredite;
20.02.2028 - 19.02.2029 15 kredite;
20.02.2029 - 19.02.2030 15 kredite;
20.02.2030 - 19.02.2031 15 kredite.

Minimum i krediteve të domosdoshme për një vit është 5, por në fund të ciklit 5 –vjeçar, totali i domosdoshëm duhet të jetë 75.

3. Çdo anëtar duhet të paraqitet pranë UFSH me dokumentacionin e kërkuar, sa herë që ndryshon vendin e punës.
4. Periudha e përvojës së punës që nevojitet për t'u bërë drejtues teknik, duhet të jetë e mbuluar me siguracione dhe të përputhet me certifikatën e anëtarësimit sipas subjektit

Nëse një farmacist është i certifikuar në një subjekt të caktuar, dhe ndërkohë siguracionet paguhen nga një subjekt tjetër, kjo periudhë nuk i njihet si përvojë pune, për tu bërë drejtues teknik.

5. Për tu bërë drejtues teknik në farmaci, nevojitet përvoja e punës me kohë të plotë prej 36 muajsh, vetëm në farmaci (private ose spitalore)
6. Për tu bërë drejtues teknik në tregtuesit me shumicë, nevojitet përvoja e punës prej 24 muajsh në shërbimin farmaceutik.
7. Çdo anëtar që dëshiron të jetë drejtues teknik në industri farmaceutike i duhen të paktën 5 vite me kohë të plotë si i punësuar vetëm në industrinë farmaceutike ose në analizat cilësore të barnave, analizat sasiore të lëndës aktive dhe në testimet dhe verifikimet e nevojshme që garantojnë cilësinë e barit.
8. Çdo farmacist që ndërpret marrëdhënie e punës me punëdhënësin dhe nuk dëshiron të ushtrojë profesionin për një kohë të caktuar, si dhe kur merr lejen e lindjes, duhet të dorëzojë pranë UFSH dokumentet e mëposhtme:

- 1- Çertifikatën origjinale të lëshuar nga Urdhri.
- 2- Pagesën e kuotizacioneve deri në momentin e dorëzimit të certifikates
- 3- Formularin e ndryshimeve

Periudha e lejes së lindjes nuk llogaritet tek përvoja e punës që nevojitet për tu bërë drejtues teknik.

9. Farmacistët që nuk e ushtrojnë profesionin për një periudhë kohe prej 5 vitesh, dhe që dëshirojnë të rikthehen në farmaci, i nënshtrohen një praktike profesionale, nën mbikëqyrjen e një farmacistit me mbi 3 vitë përvojë pune, si dhe një testimi pranë UFSH.
10. Likujdimi i detyrimeve të kuotave bëhet dy herë në vit. Afati i pagesës për gjatëmujorin e parë të vitit, është data 30 qershor, afati i pagesës për gjatëmujorin e dytë të vitit është data 31 dhjetor.

Detyrimi i kuotazacionit për farmacistet e punësuar është 500 leke në muaj,

Detyrimi i kuotazacionit për drejtuesit teknik është 1000 lekë në muaj.

Pagesa do të bëhet pranë Bankave të nivelit të dytë në numrat e llogarisë të publikuara në faqen zyrtare të UFSH <https://www.ufsh.org.al/> në rubriken “KONTAKT”

Suksese në misionin tuaj fisnik!

ZYRA E UFSH